

## Ndryshimi i përbërjes së Kuvendit të mos e ndryshojë përkushtimin në luftën kundër korrupsionit

Kuvendi duhet të jetë institucion qendror në luftën kundër korrupsionit. Në favor të pohimit të tillë është vendosja faktike e legjislativit nacional sipas të cilit Kuvendi bën përzgjedhje dhe emërim të personave në institucionet kyç për luftë kundër korrupsionit. Prandaj është me rëndësi që Kuvendi ta përforcojë rolin e vet dhe të realizojë mbikëqyrje të rregullt dhe thelbësore të punës së këtyre institucioneve.

E nevojshme është që Kuvendi të bëjë çdo gjë për të cilën është kompetente në pajtim me ingerencat. Kuvendi ka rol kyç që vazhdimisht të iniciojë fuqizim të rregullativës dhe me atë ta ngushtojë hapësirën për veprim korruptues. Miratimi i kornizës relevante ligjore duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe në konsultim me palët e involvuara.

Përbërja e fundit parlamentare e dha kontributin e vet në luftën kundër korrupsionit. Ajo u demonstrua disa herë me radhë përmes miratimit të Ligjit për luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave, zgjedhjes së përbërjes aktuale të Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit (KSHPK), si dhe shpërndarjen e mjeteve të shtuara buxhetore për punë të papenguar të KSHPK. Në atë drejtim, nga përbërja e ardhshme parlamentare pritet që ta vazhdojë dhe avancojë rolin e Kuvendit dhe të kontribuojë drejtë pro-aktivitetit shtesë.

Përbërja e ardhshme parlamentare do të ballafaqohet me disa sfida në këtë drejtim. Fillimisht, të vazhdojë me proceset reformuese të cilat përbërja e fundit nuk arriti ti zbatojë, si miratimi i ligjit për pozicion të lartë udhëheqës dhe miratimi i tekstit cilësor të Strategjisë nacionale për luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2020-2024. Miratimit, padyshim duhet ti paraprijë debat publik i cili do tu japë mundësi të gjitha palëve të involvuara, posaçërisht institucioneve për të cilat burojnë obligime nga teksti i strategjisë. Në realitet, debatet publike duhet të bëhen praktikë, në vend të oportunitet në punën e Kuvendit.

Kuvendi duhet të punojë në vendosje të vazhdimësisë së debateve monitoruese për luftë kundër korrupsionit. Praktikë e vazhdimësisë që debateve monitoruese do të krijojë traditë për raportim të rregullt nga institucionet. Llogaridhënia e rregullt e institucioneve do të kontribuojë për gatishmërinë e tyre më të madhe për raportim dhe do të dërgojnë sinjal ndaj faktorëve të tjerë se lufta kundër korrupsionit është proces i vazhdueshëm në të cilin Kuvendi është i interesuar për rezultate. Praktika e këtillë do të sigurojë gatishmëri të të gjitha palëve të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë në këtë proces.

Fillimi i negociatave me Unionin Evropian do të krijojë pritje shtesë nga Kuvendi që të imponohet si aktor kyç në luftën kundër korrupsionit, posaçërisht në monitorimin e proceset kyç për avancim në negociatat.

Projekti "Bisedë për luftë kundër korrupsionit në Kuvendin" (Anti-Corruption Talk in Parliament (ACT in Parliament)) Përfshin aktivitete hulumtuese përfaqësuese me qëllim primar të përkrahjes së procesit reformues në Maqedoninë e Veriut përmes fuqizimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit në raport me luftën kundër korrupsionit.

Projekti i përkrahur nga Fondit kombëtar për demokraci (National Endowment for Democracy – NED) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për përmbajtjen përgjegjës është IDSCS dhe në asnjë rast nuk i reflekton pozicionet e Fondit kombëtar për demokraci (National Endowment for Democracy - NED).

